

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr. 01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4298/1 datë 17.10.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4359/2 datë 24.10.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 40-të mbajtur më 24.10.2024, miratoi si vijon:

Aktvendim për vërejtje publike dhe përjashtim të ritransmetimit të shërbimit programor

1. **PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria e prodhimit të shërbimeve tregtare NAFI DHE BEKO SHPKNJP eksport-import Gostivar, për shkak se ka ritransmetuar shërbim programor i cili nuk ishte i regjistruar në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV).

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4298/1 datë 17.10.2024, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. **URDHËROHET** që operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria e prodhimit të shërbimeve tregtare NAFI DHE BEKO SHPKNJP eksport-import Gostivar, menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, pra të përjashton ritransmetimin e shërbimit programor.

3. Të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi ka vepruar sipas aktvendimit për vërejtje publike dhe përjashtimin e ritransmetimit të shërbimit programor.

4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes nga pika 1 e këtij aktvendimi, nuk vepron sipas aktvendimit, pra vazhdon të kryejë shkeljen për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia, në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LSHMAAV, do të paraqesë kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

5. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia, në pajtim me nenin 6, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të LSHMAAV, ndërmerr masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV ose të rregulloreve të miratuara në bazë të ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve nga lejet.

Në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, Agjencia është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive me kërkesë, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetet publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të këtij ligji, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, dhe në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të LSHMAAV Agjencia më 17.10.2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore në paketën programore të ritransmetuar nga operatori Shoqëria e prodhimit të shërbimeve tregtare NAFI DHE BEKO SHPKNJP eksport-import Gostivar nga ku është konstatuar se operatori në fjalë i cili sipas notifikacionit nga Agjencia për Komunikim Elektronik mund të kryej veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me datë 17.10.2024, për përdoruesit e tij ka ritransmetuar shërbimin programor që nuk mbulohet me çertifikatë për regjistrimin e shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë detajisht të specifikuara në

Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-4298/1 datë 17.10.2024, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht, nga sa mësipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 141, paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4298/1 datë 17.10.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4359/2 datë 24.10.2024, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendimin ku ndaj subjektit të mësipërm të ndërmirret masë vërejtje publike dhe urdhërohet që menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, në mënyrë që të përjashton ritransmetimin e shërbimit programor.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë ka vepruar sipas urdhrit, gjegjësisht sipas vërejtjes publike dhe ka ndërprerë ritransmetimin e shërbimit programor .

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit..

Bazuar në sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.11-4298/1 datë 17.10.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.